



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS**  
**Ministri**

Nr. ... Prot.

Tiranë, më 27.02.2012

**URDHËR**

Nr. 68, datë 27.02.2012

**PËR**

**LEJIMIN E FILLIMIT TË VEPRIMTARISË AKADEMIKE, NË PËRPUTHJE ME  
LICENSËN E DHËNË, SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE "INSTITUTI  
KANADEZ I TEKNOLOGJISË", TIRANË**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe VKM Nr.781, datë 10.11.2011 "Për licencimin e shkollës së lartë universitare private "Instituti Kanadez i Teknologjisë", Tiranë",

**URDHËROJ:**

1. Lejimin, e fillimit të veprimtarisë akademike të shkollës së lartë universitare private "Instituti Kanadez i Teknologjisë, Tiranë", për programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në:

- a) Administrim biznesi;
- b) Administrim biznesi dhe teknologji informacioni;
- c) Inxhinieri softuerike;
- ç) Inxhinieri industriale.


2. Programet e studimeve "Bachelor" të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është 3 vite akademike. Në përfundim të tyre lëshohet diplomë "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer.



3. Veprimtaria akademike, për programet e studimeve të sipërpërmendura, të fillojë në vitin akademik 2011-2012.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Zhvillimit të Arsimit Jopublik dhe shkolla e lartë universitare private "Instituti Kanadez i Teknologjisë, Tiranë".

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MYQEREM TAFAJ



MINISTËR

